




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK
DEPARTMENT OF ECONOMY DEVELOPMENT – UPRAVA ZA EKONOMSKI RAZVOJ

TURIZMI RURAL DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

RURAL TOURISM...

Gjilan, 2015

TURIZMI RURAL DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Komuna e Gjilanit shtrihet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës, është qendra kryesore në Rajonin Turistike të Ana Moravës. Komuna e Gjilanit është njëra nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë, ka një sipërfaqe prej 515 km², deri në vitin 2010 kur me procesin e decentralizimit i merren 123 km², Komuna e Gjilanit tani ka 392 km². Sipas regjistrimit të vitit 2011, Komuna e Gjilanit ka mbi 90 mijë banorë, pa u llogaritur qytetaret ne boten e jashtme .

Komuna e Gjilanit ka potenciale të mira për zhvillimin e llojeve të caktuara të turizmit, investimet e bëra kohëve të fundit nga sektori privat në turizëm ofertën turistike të Gjilanit e bëjnë atraktive për klientë len turistike vendore e ndërkombëtare.


Malet e Zhegocit, Malet e Kardakut, janë aset në vete për këtë komune ku mund të zhvillohet turizmi rural e njëkohësisht edhe turizmi i kalërimit, çiklizmit e motociklizmit, ecjes në natyrë etj.



Trashëgimia kulturore në shërbim të zhvillimit të turizmit

- ✓ Kalaja e Pogradjës, gjendet në kilometrin e 10 nga qyteti i Gjilanit, në fshatin Pogradjë, krahas kalasë është mjaft atraktive edhe Gryka e Llapushnicës

Foto e Kalasë dhe grykës së Llapushnicës.




- ✓ Atik Xhamia ndryshe e njojur si Xhamia e Medresesë, është ndërtuar në shekullin XVIII e kanë ngritur familja e Gjinollëve nga Gjilani. Statusin e monumentit në mbrojte të shtetit e ka fituar në vitin 1980.



- ✓ Xhamia e Cernicës është e ndërtuar në vitin 1775 dhe është djegur më 17 prill 1999 nga forcat serbe. Tani ajo ka mbetur si monument, i cili tregon të kaluarën e hidhur. Pjesa e mbetur është konservuar.



- ✓ Xhamia e Dobërqanit, konsiderohet xhamia më e vjetër në komunën e Gjilanit, e cila është ndërtuar në vitin 1526.



- ✓ Kisha katolike „Kisha e Shën Anës“ në fshatin Dunavë , gjendet në zonë kufitare me Preshevën dhe Kumanovën, nuk kryen më shërbime, sepse nuk ka popullatë që jeton atje. Ky monument është nën përkujdesjen e komunës së Gjilanit.



- ✓ Tyrbet në qytet, përpos xhamive, kishës ortodokse janë edhe dy objekte tjera, përkatësisht tyrbja dhe teqeja, që i takojnë komunititetit të dervishëve, më saktë tarikatit saadi. Tyrbja e Burunsuz Babës (baba i Pahundë), Tyrbja e Halvetive e njohur si Tyrbja e Hamdishehëve dhe Teqeja e Gjilanit.



- ✓ Kisha e Shën Nikollës, e cila ndodhet në rrugën “Madlin Olbrajt” e cila ende ruan një pjesë të koleksionit të ikonave, të cilat janë vendosura në mure dhe në ikonostas. Ikonat janë të. Ikonat janë marrë në mbrojtje të shtetit që nga viti 1980.



- ✓ Sahat Kulla ishte rrënuar në fillim të viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar . Tani gjendet përballë Stacionit të Autobusëve. Sahat Kulla është e lartë 30 metra kurse dimensionet e gjërësisë janë 3.80 metra. Nën moton “Po e rrënojmë të vjetrën – po e ndërtojmë të renë”, pushteti sllavo-komunist, në mënyrë perfide, ka rrënuar të gjithë monumentet dhe shenjëz imët kulturo-historike shqiptare në qytet. Në 1938, brenda natës në mënyrë të fshehtë ishte rrënuar Sahat Kulla, materialin e se cilës e kishin përdor për ndërtimin Kisha Ortodokse në Gjilan.



Atraksionet Natyrore

- ✓ Penda e Livojit : gjendet në rrugën magjistrale Gjilan – Prishtinë, karakterizohet me pejzash atraktiv për rekreacion dhe zhvillim të turizmit në natyrë.



- ✓ Lokaliteti Stublinë me rrethinë gjendet në pjesën lindore të Gjilanit është brez kufitar, karakterizohet me pejzash të bukura të natyrore, liqeni natyral, vende atraktive rekreacion dhe zhvillim të turizmit në natyrë.



Foto e fshatit Stublinë – ku lisat gjelbërimi dhe liqeni qëndrojnë në përqafim të njëri-tjetrit

- ✓ Lokaliteti Zhegoc me rrethinë, atraksionet e tija natyrore e pasurojnë dhe begatojnë edhe më shume ofertën turistike të Gjilanit, kushtet që ka ky lokalitet i mundësojnë zhvillimin e turizmit rural por edhe formave tjera të turizmit.



Foto e Stanishorë

- ✓ Lokaliteti Stanishor me rrethinë, gjendet ne kilometrin e gjashtë të qytetit te Gjilanit, në rrugën Gjilan-Novobërdë, është atraksion natyror qe ofron mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit. Investimet e bëra në infrastrukturën rrugore , objektet e akomodimit , ushqimit dhe atraksionet natyrore që ka lokaliteti në fjalë janë faktor motivuese për klienele turistike vendore e ndërkontaktare.



Foto e Liqenit të Perlepnicës

- ✓ Liqeni i Përlepnicës, është ngritur në vitin 1966, uji i të cilit shfrytëzohet për pije edhe ujite. Liqeni akumulues i Përlepnicës është formuar në lumin me të njëjtin emër. Ne liqen ka mundësi te mira për zhvillimin e aktiviteteve turistike si peshkimi, not etj. Vendi ku është i ngritur liqen është mjaft atraktiv edhe për aktivitete tjera turistike në natyrë. Përveç Liqenit të Përlepnicës , komuna e Gjilanit ka edhe liqenin ne Livoqit qe gjendet buzë Magjistrales Gjilan- Prishtinë.



Foto e burimeve termale

- ✓ Burimet termale, komuna e Gjilanit është e pasur edhe me burime të ujërave termale të cilat , janë pjese e ofertës turistike të kësaj komune. Në Uglarë dhe Doberqan janë të njohura burimet e ujërave termale të cilat përveç që kanë veti shëruuese ne këto dy lokalitete shkojnë turist në numër të konsiderueshëm edhe për rekreacion.



Baja e Doberqanit dhe e Uglaritë

Objektet e akomodimit dhe ushqimit

Në komunën e Gjilanit janë 244 ndërmarrje dhe punëtori hoteliere të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime të fjetjes, ushqimit, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, ahengjeve familjare, banketeve, seminareve, trajnimeve dhe shërbimeve të tjera. Hoteleria furnizimin me mallra e bën nga tregu i brendshëm, mall i cili kryesisht është importuar nga shtetet ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore . Objektet hoteliere kryesisht janë të ndërtuara në brendi të qytetit dhe pjesërisht në pjesët periferike.

- Hotel "Kristal" gjendet ne qendër të qyteti të Gjilanit, i cili ofron shërbimet e akomodimit, ushqimit, ka hapësira të mjaftueshme edhe për zhvillimin e turizmit konferencial.
- Restorant "Bujana" , gjendet ne hyrje të Gjilanit (Magjistralja Gjilan – Ferizaj) ofron shërbimet e ushqimit tradicional
- Restorant "Vali Ranch" , gjendet ne fshatin Perlepnice (Magjistralja Gjilan – Kamenicë) ofron shërbimet e ushqimit tradicional. Dashuria e natyrës dhe kafshëve - ne duam të ju jap se ndjenja gjatë qëndrimit tuaj në fermën tonë. Një vakt të mirë në fund kuzhinës restorantin tonë komod për ditën tuaj jashtë me ne.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik - Gjilan

Fadil OSMANI, Zyrtar për Promovimin e Investimeve

mob: +377 45 218 100

E-mail: fadiilosmani02@yahoo.com